



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 prill 2015, në mbledhjen e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, me përjashtim të, znj.Fatlume Jaha dhe z.Haki Rudari, të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

Në cilësinë e mysafirëve, pjesëmarrës në mbledhje ishte edhe një grup i nxënësve të klasës së pestë nga shkolla fillore e mesme e ulët "Ilir Konushefci" në fshatin Llugë, së bashku me mësuesen e tyre znj. Ardita Sokoli.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe shtoi, konsideroj se rendi i ditës së bashku me materialin e kësaj mbledhje iu është dërguar me kohë të cilin edhe e keni marrë me kohë duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë. Ju njoftoj se me 5 Maj është Dita e Dëshmorëve dhe të Rënëve ku ndër aktivitetet e tjera është paraparë të mbahet një manifestim në Kompleksin "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan, më shumë detaje rreth aktiviteteve në këtë ditë mund t'i gjeni në ftesat për pjesëmarrje që besoj se të gjithëve ju kanë dhënë.

Gjithashtu ju njoftoj se këshilltarët e Kuvendit, z.Kadri Avdiu, z.Naim Çunaku dhe z.Xhevdet Beselica, mua si Kryesues i Kuvendit të Komunës më kanë njoftuar me një shkresë në të cilën thuhet, *bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.01/146-11 dhe duke u mbështetur në nenin 74.1 dhe 74.3, ju informojmë se ne anëtarët e Kuvendit komunal, Kadri Avdiu, Xhevdet Beselica dhe Naim Çunaku, nga tani funksionojmë si Grup i pavarur i Kuvendit të Komunës. Duke u mbështetur në nenin 75.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.01/146-11, ju informoj se Grupin tonë e përfaqëson z. Kadri Avdiu, si dhe Grupi quhet, Grupi Plus.*

Ne e përshëndesim dhe i urojmë punë të mbarë Grupit të ri të këshilltarëve Kuvendit, dhe mund të fillojmë me punë.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me siguri se konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë i keni marrë para fillimit të kësaj mbledhje duke përfshirë edhe materialin e propozimit të vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Grumbullimin, Ruajtjen dhe Përpunimin e Pemëve e Perimeve në fshatin Sfeqël, Komuna e Podujevës, i cili është rekomanduar për përfshirje në kuadër të rendit të propozuar të ditës për këtë mbledhje të Kuvendit, andaj nëse nuk ka vërejtje, plotësime tjera ose ndonjë sugjerim, e hedh në votim rendin e ditës duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në kuadër të pikës së pestë të rendit të ditës përfshihet edhe pika shtesë:

- **Propozimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Grumbullimin, Ruajtjen dhe Përpunimin e Pemëve e Perimeve në fshatin Sfeqël, Komuna e Podujevës**

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 31 mars 2015

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 31 mars 2015.

3. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2015

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj t'ju njoftoj se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ne kemi debatuar për këtë raport dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim duke përfshirë edhe çështjet e cekura në konstatimet e miratuara në atë mbledhje, përkatësisht, në faqen 5 të raportit kodi 13141 ku thuhet “Mëditje për udhëtime brenda vendit” të korrigjohet “Mëditje për udhëtime jashtë vendit”, si dhe dy rekomandime tjera, dhe atë;

- Të ndërmerren masat dhe aktivitetet përkatëse për shtimin e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave vetanake, dhe

- Drejtorët e Drejtorive përkatëse, në aspektin e investimeve kapitale të iniciojnë me kohë procedurat e prokurimit në mënyrë që dinamika e realizimit të projekteve prioritare dhe shpenzimeve të bëhet sipas dinamikës së planifikuar.

Edhe pse të gjitha rreth këtij raporti janë të shkruara në material, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, do të paraqesë një fjalë hyrëse.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Raportit Financiar për periudhën janar – mars 2015.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështesim këtë raport financiar për periudhën janar-mars 2015, raport i cili është përgatitur në harmoni me Ligjin për Financat dhe i cili pasqyron në mënyrë shumë të qartë inkasimet dhe shpenzimet e mjeteve financiare për periudhën tremujore të vitit 2015.

Gjithashtu shfrytëzoj rastin që Grupit të ri të këshilltarëve të Kuvendit, Grupi Plus, t'i dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë tash e tutje.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar për raportin financiar për periudhën janar-mars 2015. Sot kemi pritur që të bëhet një përmirësim në raport ashtu siç drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e tha në mbledhjen e KPF-së se do të korrigjojmë këtë gabim i cili është teknik, dhe nëse ai përmirësim nuk është bërë atëherë shuma e shpenzuar për mëditje brenda vendit, mbetet zyrtare dhe ato pagesa mbesin joligjore.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke i kërkuar falje për ndërhyrje e njoftoj se korrigjimi për të cilin është duke folur, është bërë dhe është përfshirë në konstatime të miratuara në KPF, të cilat pastaj do të inkorporohen në materialin përkatës.

z. Rafet Llapashtica, vazhdoi, Konstatimet mund të jepen në formë gojore, mirëpo ajo çka shkruan në material dhe që na dërgohet neve këshilltarëve të Kuvendit, ajo është zyrtare, e jo konstatimi i dhënë. Gjithashtu i kam shtruar pyetje drejtorit të DBF, që të na njoftoj për shumën prej 25,924.00 € të ardhura tjera, mjete të cilat nuk dihet se nga janë inkasuar në buxhetin e Komunës, pastaj pyetja tjetër ka qenë për shumën 1,864.17 € furnizim me ushqim dhe pije dhe pagesa tjetër prej 1,100.00 € si pagesë në të njëjtin kod, e që gjithsejtë përbëjnë shumën 2,964.17 €, shumë për të cilën kërkojmë që drejtori të na njoftoj se kush është furnizuar me ushqim dhe pije si dhe cila ka qenë arsyeja e këtij furnizimi sepse ne të gjithë jemi në dijeni se zyrtarëve komunal dhe atyre shtetërorë nuk kemi për obligim ne si qytetarë që t'iu paguajmë ushqim dhe pije, apo në çoftë se ka pasur ndonjë rast shëndetësorë – social i cili është furnizuar me ushqim dhe pije, mendoj se është dashur të njoftohemi edhe ne këshilltarët e Kuvendit në mënyrë që edhe ne të jemi kontribuues. Shpenzimet e telefonisë, shuma 3,694.00 €, përkatësisht 1808,07 € janë shpenzuar vetëm për telefoninë celulare kurse 1,885.99 € për telefoni fikse, mendoj se është dëmtuar buxheti i Komunës. **z. Fidan Rekaliu** e lavdëroi këtë dokument, mirëpo unë e kuptoj se drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në këtë dokument vetëm i ka renditur pagesat në kode përkatëse nga të cilët është dashur të bëhen pagesa ku një prej tyre është pagesa e dhunshme e Ministrisë së Financave për fatura të cilat Komuna e Podujevës nuk i ka bërë pagesat, do të thotë janë tërhequr mjetet buxhetore, gjë e cila është shqetësuese. Problem tjetër shqetësues është rënia e të hyrave vetanake, ku kryesisht në këto të hyra dominon inkasimi nga tatimi në pronë, kurse drejtori i DBF-së në mbledhjen e KPF-së e tha se jemi shqetësues sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake ngase këtë e ka zbehur pak sa Vendimi i Qeverisë së Kosovës për faljen e një pjese të borxheve dhe kjo ka bërë që të zbritet 3.4% inkasimi i të hyrave vetanake të Komunës. Është seanca e katër me radhë që Grupet e këshilltarëve nga radhët e opozitës kanë kërkuar listën e pronave komunale duke ju bashkëngjitur atyre edhe vendimet me të cilët janë dhënë në shfrytëzim, pronat të cilat janë dhënë pa vendim, dhe pronat të cilat janë të uzurpuara, e them këtë ngase jemi në dijeni se një pjesë e pronave të Komunës janë të uzurpuara madje edhe nga përfaqësues politik, konkretisht edhe nga persona të cilët janë

pjesë e partisë e cila udhëheq me Komunën siç është rasti i objektit të postës në fshatin Lluzhan që është uzurpuar, andaj normalisht që nga ajo pronë nuk mund të inkasohen të hyra, nuk dëshiroj të thellohem në prona tjera të uzurpuara por mendoj se kjo mjafton për qeverisjen aktuale të Komunës që ta din se një pronë është e uzurpuar nga një përfaqësues i atij subjekti dhe nuk mund të inkasohen mjete nga ajo pronë. Pra mendoj se ngritja e rënies të të hyrave vetanake do të vazhdoi dhe do të thellohet ende deri në fund të vitit. Në mbledhjen e kaluar, drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë ka zgjedhur rrugën më të mirë sipas tij, që të mungoj në mbledhje vetëm e vetëm për të mos na ofruar listën e pronave të Komunës. Në vend që në vitin 2015 të ketë ngritje të të hyrave vetanake, del e kundërta ka rënie, e them këtë duke qenë në dijeni që qeverisja komunale do ta kishte më të lehtë të investoi sepse këto të hyra nuk mund t'i menaxhoi askush tjetër përveç Komunës. Çështje tjetër që duhet të ceket është, investimet kapitale, e që për këtë tremujorë janë investuar vetëm 80,000.00 € nga shuma e përgjithshme vjetore për këtë kategori që është rreth 5 milion euro, për mendimin tim kjo është qesharake dhe tregon një paaftësi të Drejtorive përkatëse për të realizuar projektet e Komunës, sepse ne të gjithë jemi në dijeni se nevojat janë të shumta për investime, por ka edhe projekte të cilat kanë mbetur në gjysmë, dhe në këtë drejtim kam pyetje për drejtorin përkatës rreth ndërtimit të rrugëve lokale për këtë periudhë, cilat janë ato rrugë të cilat janë mirëmbajtur, asfaltuar apo janë riparuar, ngase realisht jemi të interesuar të dimë se kush ka përfituar nga këto pagesa që janë bërë në këtë tremujorë.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket këtij raporti financiar janar-mars 2015 ne nuk shohim asgjë tjetër përveç një përsëritje apo diçka të njëjtë me raportin e fundit financiar dhe kjo na bënë të kuptojmë se nuk ka ndodhur asgjë e re që ne do të mund të merremi me atë, për ndryshe prej se bëhen raporte të tilla financiare, mund të them se në një formë janë të gjithë, copy paste, njëri pas tjetrit, sepse gjithherë janë marrë me ngritje – zbritje të kodeve të ndryshme, gjë për të cilën nuk dëshiroj të thellohem se ku ka ngritje – zbritje të kodeve, por një gjë e cila më ka bërë përshtypje në këtë raport është, favorizimi po thuajse i njëjtë i investimeve sa i përket fshatrave në Komunën e Podujevës, e them këtë ngase gjithherë si me ndarje të buxheti ashtu edhe në raporte financiare vërehen favorizime të njëjta të fshatrave të territorit të Komunës së Podujevës dhe se janë një numër i njëjtë i fshatrave në të cilët gjithherë investohet. Çështje tjetër e cila më ka bërë përshtypje është edhe favorizimi i kompanive fituese të tenderëve, sepse gjithherë favorizohen kompani të njëjta, andaj për këtë kemi pyetje të thjeshta, a janë gjithherë ato kompani më të lirat me çmime, a janë gjithherë ato kompani të cilat e bëjnë punën më të mirë dhe a janë ato kompani më të rregulltat, duke qenë në dijeni se çfarë pune kryhet në Komunën e Podujevës ku çdo ditë bëhen renovime të rrugëve dhe kanalizimeve si dhe cilësia e punëve është shumë e dobët, pra nëse thirremi se ato kompani kryejnë punë të mirë mendoj se gabohemi, apo këto kompani fituese mund të kenë ndonjë partneriteti, ose shoqërie me ndokënd brenda Komunës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk jam duke vërejtur ndonjë këshilltar që dëshiron të merr fjalën, por nga parafolësit pati pyetje dhe kërkesa tjera për sqarime, i ftoj drejtorët e Drejtorive përkatëse të japin ato.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, do të mundohem që shkurt dhe qartë t'i jap disa përgjigje dhe sqarime të cilët u kërkuar nga unë.

Rreth pyetjes që ka të bëjë me pozicionin, të ardhura tjera në shumë 25,924.00 €, përgjigja është se shuma prej 24,824.00 € i takojnë taksave administrative të paguara në

arkën komunale, ku të gjitha taksat e paguara deri në shumën 10 € janë, të hyra tjera, kurse 1100 € i janë nga taksat të cilat paguhen në emër të rendit të udhëtimeve, si taksitë, autobusët, kombibusët etj, të cilët me rastin e aplikimit për leje të një rendi të udhëtimi paguajnë taksë, e që deri në këtë përdhë raportuese janë hyrë 1100 € në buxhetin e Komunës. Sa i përket pagesave për udhëtime brenda vendit, unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e sqarova shumë qartë se kemi të bëjmë me një gabim teknik sepse ato pagesa janë bërë për udhëtime jashtë vendit e jo ashtu siç figuron në raport, gabim teknik i cili ka hyrë edhe në konstatimet e rekomanduara nga KPF-ja, po ashtu ju do të mund të shihni në ueb-faqe zyrtare të Komunës Raportin Financiar janar-mars 2015 i cili do të publikohet i përmirësuar sepse është realitet që pagesat janë bërë për udhëtime jashtë vendit. Lidhur me çështjen që u ngrit për kodin ushqim dhe pije, sigurisht se jeni në dijeni se Komuna e financon Çerdhen e Fëmijëve, e cila është publike, ushqimi dhe pijet që merren për furnizim të asaj çerdheje paraqet shpenzim në kodin ushqim dhe pije por që nuk dallohet ushqimi nga pijet por hyjnë të dyja bashkërisht, kod në të cilin hynë edhe pijet të cilat tani për tani kemi para vetës. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve lokale, ajo është mirëmbajtje dimërore e të gjitha rrugëve që në periudhën dimërore kanë nevojë të mirëmbahen, rrugë për të cilat kemi pasur dy kompani të cilat kanë mirëmbajtur rrugët lokale, ato të qytetit në veçanti, andaj shpenzimet të cilat reflektojnë te pozicioni mirëmbajtja e rrugëve janë shpenzime të cilat janë pikërisht për këtë qëllim. U tha se gjoja unë e kam cekur se është shqetësuese Vendimi për faljen e borxheve i marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, unë nuk e thash ashtu, por e thash se është një lloj indikacioni apo një lloj pengese që te qytetarët ka shkaktuar pak sa hezitim për kryerjen e obligimeve ndaj Komunës deri sa të sqarohet gjegjësisht qartësohet me ligj se si do të bëhet falja e borxheve, vlen të ceket se ka raste ku qytetarët vijnë në Zyrën time dhe pyesin pse të paguajmë borxhet kur ato i ka falur Qeveria, dhe mua më duhet t'jua qartësoi se tani për tani nuk kemi ligj, udhëzim apo ndonjë vendim të tillë, por kur të rregullohet kjo çështje atëherë ne mund të zbatojmë këtë. Prandaj në këtë kontekst e thash se ka hezitim nga ana e qytetarëve për kryerjen e obligimeve komunale, edhe pse në këtë aspekt kemi një rënie të lehtë ngase në këtë periudhë të vitit të kaluar kanë qenë rreth 96,000.00 € kurse në këtë vit janë 90,000.00 €, do të thotë është një rënie e lehtë dhe është një diferencë jo edhe aq shqetësuese sepse duhet të kemi parasysh edhe periudhën tremujore të fillim vitit ku të ardhurat e qytetarëve sigurisht se janë më vogla, por meqenëse është rënie ne e kemi paraqitur atë në raport.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, përshëndetjen e veçantë i bëri grupit të nxënësve të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Ilir Konushëfci" nga fshati Llugë të cilët kanë shprehur dëshirën e tyre për të parë nga afër mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Komunës përkatësisht për të përcjellë një mbledhje të Kuvendit.

Gjithashtu Grupit të ri të këshilltarëve të Kuvendit i cili zyrtarisht e formalizoi këtë Grup në fillim të kësaj mbledhjeje i uroj, punë të mbarë në të ardhshmen, dhe shtoi, kjo është një shenjë e cila tregon se në Kuvendin e Komunës së Podujevës kemi funksionim të mirë të demokracisë, gjë për të cilën sigurisht që edhe OSBE-ja duhet të jetë e kënaqur sepse në vijimësi është angazhuar dhe ka punuar në promovimin e demokracisë.

Kryetari i Komunës z. Agim Veliu, vazhdoi, fjalën e mora që t'ju siguroj se raportet financiare në vijimësi punohen me kujdesin më të madh dhe nuk ka kurrfarë ngurrimi nga ana ime por as nga ana e Ekzekutivit të Komunës që t'i paraqes lëvizjet çfarëdo qofshin

ato, pozitive apo negative, me ngritje apo me rënie të shpenzimeve, pra e them se edhe ky raport paraqet gjendjen reale të të hyrave dhe shpenzimeve, dhe nuk qëndron ajo që u tha nga një këshilltarë parafolës se ky raport është vetëm një kopje e raporteve të mëparshme, kjo gjë mund edhe të vërtetohet ngase raportet e mëparshme financiare ekzistojnë dhe mund të krahasohen dhe analizohen, andaj në raportet përkatëse paraqiten të gjitha lëvizjet financiare që është obligim konform Ligjit për Financave Publike.

Po ashtu dëshiroj të ripërsëris edhe njëherë se nuk qëndron ajo që në vijimësi është duke u thënë në këtë Kuvend nga disa këshilltarë se kinse Ekzekutivi i Komunës favorizon fshatra dhe lokalitete të ndryshme sa i përket investimeve, ngase investimet bëhen në bazë të planifikimeve dhe kërkesave që vijnë nga qytetarët dhe nga lokalitetet e ndryshme, pa kurrfarë dallimesh, andaj nuk kemi interesin më të vogël që të bëjmë dallime të vendbanimeve tona sepse interesimi jonë është që Komuna e Podujevës të jetë e zhvilluar njësoj sa i përket infrastrukturës dhe investimeve të tjera.

U përmend se ka favorizime të kompanive të cilat marrin punë nga Komuna, këtë gjithashtu më duhet ta demantoj ngase në Komunën e Podujevës nuk ka favorizime të kompanive dhe nuk qëndron vërejtja e cekur, e kjo çështje mund të vërtetohet edhe duke parë listën e të gjitha kompanive fituese në vitin e kaluar ku mund të vërehet se ka kompani nga Komuna e Podujevës por ka edhe kompani nga komuna të ndryshme të Kosovës, pra janë kontraktuar kompani të cilat kanë ofruar çmimet më të ulëta dhe më të favorshme për Komunën e Podujevës, këtë gjë e vërtetojnë edhe raportet e auditimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm por edhe nga Auditori i Brendshëm, andaj me kënaqësi ju them se në dy vitet e kaluara të gjitha procedurat e prokurimit që janë zhvilluar në Komunën e Podujevës kanë kaluar pa pasur probleme, pa pasur ankesa dhe pa pasur anulime nga autoritetet më të larta, dhe po ashtu kjo çështje pasqyrohet shumë mirë në raportet e auditimit, por edhe nga raportet e herëpashershme për Komunat që bënë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ku Komuna e Podujevës radhitet në mesin e Komunave më të mira sa i përket disa shpenzimeve të cilat zakonisht atakohen në mbledhjet e Kuvendeve komunale.

z. Flakron Gashi, theksoj, sa i përket raportit financiar për tremujorin e parë të këtij viti, dua të ndërlihem tek çështja e të hyrave komunale nga shfrytëzimi i pronës komunale, nga taksat e pronës, dhe nga të hyrat nga donatorët. Në raport vërehet se nga shfrytëzimi i pronës komunale shuma të hyrave është 24,561.00 €, unë i mbështes parafolësit këshilltarë të Kuvendit të cilët e ceken se pas shumë disa kërkesave të bëra në këtë Kuvend, ne ende nuk kemi marrë një material të përmbledhur me të dhëna të evidentuara pronë për pronë dhe me të gjithë personat të cilët i shfrytëzojnë ato prona.

Gjithashtu sa i përket taksës së tatimit në pronë për të cilën drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e përmendi se ka një rënie të lehtë, unë mendoj që Komuna nuk ka pasur një strategji të qartë dhe nuk ka pasur vullnet që t'iu qaset më ndryshe qytetarëve karshi mbledhjes së kësaj takse sepse gjithherë qytetarëve iu kërkohet që të paguajnë borxhin e vjetër kurse borxhi i ri prapë mbetet borxh i vjetër vitin e ardhshëm, gjë për të cilën konsideroj se është një qasje e gabueshme, gjithashtu në mënyrë relative ka pasur raste ku jo për të gjithë ka qenë e obligueshme të paguajnë borxhin e tatimit në pronë, jemi në dijeni se ka qenë një kusht që për regjistrimin e veturave është dashur të paguhet edhe borxhi i vjetër, mirëpo jeni në dijeni se unë e kam ngritur edhe në seanca të mëparshme se ka raste ku individ të caktuar mund të marrin atë vërtetim edhe pa paguar

fare dhe kjo krejt varet nga vullneti i zyrtarëve të cilët punojnë në atë zyrë, andaj në qoftë se falen këto borxhe mendoj se është e pafalshme dhe është mëkat që Komuna nuk ka inkasuar këto të hyra dhe që ka humb miliona euro, dhe nëse do të inkasoheshin ato mjete rreth 5 milion euro, sigurisht se në investime kapitale do të ndikonte drejtpërsëdrejti në interesin e qytetarëve. Sa i përket investimeve kapitale, në këtë raport shihet se është investuar një shumë prej 30,000.00 €, e që unë mendoj se në proporcion me shumën afër 5 milion euro, e cila është e paraparë në buxhetin e Komunës për këtë kategori, është shumë e vogël e mjeteve të investuara në këtë tremujorësh të parë të vitit dhe shpresoj se ky ritëm të rritet e mos të mbetet kështu sepse deri në fund të vitit as 15% e buxhetit për investime kapitale nuk do të shpenzohen.

Shfrytëzoj rastin që Grupit të ri të këshilltarëve të sapoformuar, t'i uroj punë të mbarë sepse është e drejtë që secili prej nesh t'i shpreh bindjet e veta politike, ndërsa Kryetarit të Komunës i them që demokracia nuk funksionon vetëm atëherë kur të lëvizin Grupet ose këshilltarët e Kuvendit, por demokracia funksionon edhe atëherë kur drejtorët e Drejtorive veprojnë karshi interesave të qytetarëve dhe kërkesave të këshilltarëve të Kuvendit, si dhe demokracia funksionon kur drejtori z. Abaz Llugaliu të na ofroi të dhënat e kërkuara, në mënyrë që të jemi në dijeni se si shfrytëzohet prona komunale dhe cilat janë ato.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, dua të sqaroj rreth strategjisë për inkasimin e të hyrave vetanake të Komunës, është pikërisht e kundërta me atë që parafolësi e ceku sepse çdo qytetarë i cili paguan obligimin e tatimit në pronë, shlyerja e borxhit fillon nga lart, do të thotë 2014-2013-2012 e kështu me radhë, dhe nuk qëndron ajo që u tha se shlyerja e borxhit bëhet nga vitet e mëparshme, 2000-2002 e këndej, kështu që nëse parafolësi nuk e ka pasur këtë informatë shfrytëzohet rasti që të njoftohen edhe të tjerët se si bëhet shlyerja e borxhit nga tatimi në pronë dhe se strategjia e shlyerjes së borxhit të tatimit në pronë fillon nga lart-poshtë e jo nga poshtë-lart.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, mora fjalën me qëllim që të jap disa sqarime dhe përgjigje. z. Rafet Llapashtica e tha se nuk na është dërguar lista e pronave të Komunës të dhëna në shfrytëzim, unë atë listë ju kam dërguar në e-mail zyrtar në seancat kur edhe është bërë kërkesa nga ana juaj, mirëpo unë nuk kam pasur asnjëherë një kërkesë të tillë si pikë të rendit të ditës në mënyrë që t'ju jap të gjithë këshilltarëve të Kuvendit një listë të tillë, por sido që të jetë kjo nuk paraqet kurrfarë problemi që ta merrni atë listë, vlen të ceket se atë listë e ka kërkuar dhe u është dhënë edhe Auditorit të Jashtëm, pra lista ekziston dhe nuk mund të thuhet se nuk u është dhënë këshilltarëve të cilët e kanë kërkuar atë sepse unë jua kam dërguar ne e-mail tre ose katër këshilltarëve të Kuvendit të cilët kanë kërkuar një gjë të tillë, mirëpo nuk ka kurrfarë problemi që ta merr këtë listë edhe z. Flakron Gashi i cili pak më parë e kërkoj. Sa i përket asaj që u tha se gjoja unë e kam zgjedhur rrugën më të lehtë që në seancën e kaluar të mungoj në mbledhje, nuk qëndron ajo sepse arsyeja e mungesës në atë mbledhje është se kam pasur një takim mjaft të rëndësishëm në lidhje me kadastrin ku një kompani Japoneze është duke financuar një sistem të ri të kadastrit – Kadastral MAP, dhe mua me tre zyrtar tjerë na është dashur të jemi prezent në atë punëtori, dhe për këtë unë e kam njoftuar Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit. Po ashtu u përmend prona komunale, ish Posta në fshatin Lluzhan, për të cilën ju informoj se nga procedura administrative me kërkesë të palëve ka kaluar në procedurë gjyqësore dhe shumë shpejt pritet të përfundoj kjo çështje, pra kjo është e vërteta dhe kjo çështje është transparente sepse nuk ka çka të mbahet fshehtë. Lidhur me dhënien e

pronave të Komunës në shfrytëzim, sigurisht se jeni në dijeni se nga ky Kuvend është ngritur Komisioni përkatës dhe të gjitha pronat që jepen në shfrytëzim, jepen nga ai Komision në të cilin bëjnë pjesë edhe përfaqësues të subjekteve të këtij Kuvendi.

z. Flakron Gashi, theksoi, lidhur me sqarimin që e bëri drejtori i DBF z. Isuf Latifi, unë në formë të replikës i përgjigjem me një shembull shumë të qartë, drejtori mendoi se më kundërshtoi mua mirëpo ai e kundërshtoi praktikën e cila është duke u zhvilluar nga zyrtarët e Komunës dhe është pikërisht ajo që kërkohet nga poshtë-lartë dhe jo nga lartë-poshtë, këtë e them nga përvoja ime personale që kam pasur në lidhje me këtë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, kërkova fjalën që të shfrytëzoi prezencën e Kryetarit të Komunës në këtë mbledhje dhe t'i parashtroj dy pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me Zyrën e prokurimit, a mendon Kryetari i Komunës që ndonjëherë të bëjë planifikimin vjetorë të dinamikës së realizimit të prokurimeve në Komunë. Pyetja e dytë është, ky Kuvend i Komunës a do të ketë ndonjëherë një raport financiar të auditimit të brendshëm, sepse po bëhen dy vite që një raport i tillë nuk na është prezantuar.

z. Bahri Selimi, theksoi, u detyrova të marr fjalën me qëllim që të jap një sqarim rreth pronave komunale për të cilat ka pasur kërkesa të jetë pikë e rendit të ditës, kurse drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e tha se nuk ka pasur kërkesa që për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim dhe listën e atyre pronave të kemi pikë të veçantë të rendit të ditës, andaj nëse e shfletoni procesverbalin e mbledhjes së XIII dhe IV-të do të shihni se në këto dy mbledhje është kërkuar të futet në rend të ditës një raport nga Drejtoria e cekur, rreth mënyrës dhe formës se si janë dhënë në shfrytëzim pronat komunale nga Komuna e Podujevës në këtë mandat.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, ne i dëgjuam të gjithë parafolësit paraprak ku disa prej tyre ngritën disa shqetësime që për mendimin tim janë shumë të paarsyeshme ngase ne si këshilltarë të këtij Kuvendi në çdo kohë kemi të drejtë të kërkojmë raporte, çoftë individualisht apo gruporë, andaj nuk është e thënë që drejtori i një Drejtorie për një kërkesë të ndonjë individi të përgatiti dhe shpërndan 35 materiale për secilin këshilltarë. Gjithashtu gjithsecili që ka pasur kohë dhe që ka pasur interesim ka mund të shkoi në Zyrën e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë apo në ndonjë Drejtori tjetër përkatëse dhe të kërkojë të gjitha dokumentet që i interesojnë atij, qoftë edhe raportet e auditorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket pyetjes për Zyrën e prokurimit, mund t'ju them se Komuna e Podujevës përkatësisht Zyra e prokurimit në çdo fillim të vitit planifikimin vjetorë të prokurimit më dërgon mua në cilësinë e Kryetarit të Komunës por e dërgon edhe në instancat tjera për të cilat është e obliguar me dispozita ligjore, dhe kjo mund të vërtetohet nga këshilltari që parashtroi këtë pyetje i cili pas kësaj mbledhje mund të shkon në Zyrën e prokurimit dhe të kërkon planifikimin e aktiviteteve të prokurimit. Sa i përket pyetjes së dytë të parashtuar po nga i njëjti këshilltar, mendoj se kjo pyetje është bërë në adresë të gabuar sepse obligim i yni është që t'i përfundojmë punët tona dhe të bëjmë auditime të brendshme për sektorë të caktuar dhe aktivitete të caktuara për të cilat kërkohen auditime, ndërsa është çështje e juaja si këshilltarë të Kuvendit se a kërkon apo jo të shqyrtohet në këtë Kuvend një raport i auditorit të brendshëm sepse nuk jam unë ai që e caktoi një gjë të tillë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me qenë se nuk ka të lajmëruar këshilltarë tjerë për diskutim unë e përfundoi këtë pikë të rendit të ditës, materialin bazë të raportit financiar për periudhën janar – mars 2015 e posedoni duke përfshirë edhe

konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të cilat i keni marrë në fillim të kësaj mbledhjeje, gjithashtu dëgjuat edhe arsyetimet dhe sqarimet e Kryetarit të Komunës dhe të disa drejtorëve të Drejtorive përkatëse, andaj e hedh në votim këtë raport së bashku me konstatimet e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 11 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, miratohet Raporti Financiar për periudhën janar – mars 2015 duke përfshirë edhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

4. Miratimi i propozim Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2015–2018.

➤ Raporti për zbatimin e diskutimit publik.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht se të gjithë e keni pranuar raportin e Grupit punues nga diskutimi publik që është mbajtur ditën e caktuar nga ky Kuvend përkatësisht më 15 prill 2015, kurse materialin e strategjisë e keni në posedim nga mbledhja e kaluar, ju informoj se në këtë raport janë përfshirë disa vërejtje, plotësime dhe sugjerime të dhëna diskutim publik, të cilat i kemi konsideruar të arsyeshme, sikurse që i kemi marrë edhe nga diskutimet që janë bërë në KPF dhe në Kuvend në mbledhjet e paraprake ku disa nga ato janë inkorporuar në materialin bazë. Gjithashtu për këtë ne kemi diskutuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, mirëpo sido që të jetë unë e hapi debatin, dhe nuk ka të interesuar për diskutim, e hedh në votim propozim Strategjinë përkatëse bashkërisht me raportin nga diskutimi publik.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Strategjia Komunale për Informim dhe Komunikim me Publikun 2015 – 2018 duke përfshirë raportin nga diskutimi publik dhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Propozimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për Grumbullimin, Ruajtjen dhe Përpunimin e Pemëve e Perimeve në fshatin Sfeqël, Komuna e Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, i njoftoj këshilltarët e Kuvendit rreth këtij propozim vendimi, dhe shtoi, ky është një investim i cili pritet të bëhet duke e falënderuar Kryetarin e Komunës i cili në bashkëpunim me Komisionin European kanë arritur marrëveshje për ndërtimin e objektit përkatës, mirëpo ne si Kuvend i Komunës kemi për obligim të caktojmë lokacionin për ndërtimin e atij objekti i cili do të investohet nga Komisioni por që pastaj do të mbetet në pronësi të Komunës,

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

6. Të Ndryshme

znj. Florije Maliqi, theksoi, është hera e dytë që ne si këshilltarë të Partisë Demokratike të Kosovës kërkojmë që të bëhen vizita sistematike të nxënësve nëpër shkolla, por kjo kërkesë e jona deri tani ka hasur në veshë të shurdhër. Kontrolli i nxënësve nëpër shkollat e komunave tjera ka treguar efikasitet të madh në parandalimi e shumë sëmundjeve, anomalive dhe deformiteteve tjera. Me marrjen e kësaj iniciative, pra me vizita sistematike të nxënësve në shkolla do të bëhet vlerësimi i gjendjes shëndetësore të nxënësve, identifikimi i deformiteteve tjera, anomalive apo sëmundjeve tjera specifike për moshën dhe ndërmarrja e masave për parandalimin dhe komplikimin e tyre. Andaj ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së kërkojmë që sa më shpejt të fillohet kontrolli i nxënësve nëpër shkolla sepse kjo ndikon në shëndetin e qytetarëve tanë Llapjan, dhe mbesim me shpresë se kjo kërkesë do të mbështetet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe të fillon menjëherë me marrjen e masave për realizimin e këtij projekti.

znj. Kumrie Hoti, theksoi, më duhet t'i adresoj disa çështje të cilat përbëjnë shqetësim të qytetarët. Kemi të bëjmë me krijimin e deponive të egra të mbeturinave të cilat përveç denigritit të ambientit përbëjnë rrezik edhe për shëndetin. Gjendja paraqitet të jetë shqetësuese dhe kjo shihet edhe nga fotografitë e bëra një ditë më parë në fshatin Revuç dhe para Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Kërprimëh, *(prezanton disa fotografi)*. Kërkoj nga personat përgjegjës të ndërmarrin masat adekuate dhe të zgjidhin këtë çështje duke ofruar shërbimet e veta edhe në këto lokalitete. Çështja tjetër që është po ashtu e një rëndësie të madhe është mungesa e ujit të pijes në shkollat e fshatrave Kërprimëh, Pakashticë dhe Metehi, në të cilat nuk ka ujë të pijes dhe nxënësit çdo ditë i ekspozohen rrezikut të ndonjë sëmundje nga uji i papastër. Shpresoj dhe dua të besoj se personat kompetent do të merren me këto çështje dhe do të ndërmarrin hapa konkret në zgjidhjen e tyre. Gjithashtu shpresoj që nuk do të na thuhet se nuk ka mjete buxhetore për këto projekte sepse kjo do të ishte e papranueshme për faktin se në raportin financiarë që na është dorëzuar dhe të cilin e shqyrtoam në këtë mbledhje, Komuna ka shpenzuar mjete financiare për çështje të cilat për nga rëndësia dhe interesi përgjithshëm i qytetarëve nuk kishin kurrfarë rëndësie në krahasim me çështjet që i theksova.

z. Naim Çunaku, theksoi, dëshiroj t'ju bëjë një përshëndetje të veçantë nxënësve të shkollës "Ilir Konushevci" nga fshati Llugë, i kam dy arsye kur them, përshëndetje të veçantë, sepse unë personalisht vijë nga ai fshat dhe shumicën nga këta nxënës i njoh, duke i përgëzuar për angazhimin dhe interesimin e tyre për të përcjellë punën e Kuvendit të Komunës, dëshiroj që këta nxënës të jenë ata të cilët në të ardhmen do të jenë në ulëset e Kuvendit të Komunës së Podujevës por edhe në ulëset e instancave më të larta të shtetit. Gjithashtu do të doja që ne si Kuvend i Komunës t'i gëzojmë këta nxënës duke jua mbështetur ndonjë projekt të tyre me qëllim të lehtësimit të kushteve të tyre për mësimnxënie. Meqë vij nga ai mes jam në dijeni dhe i informoj këta nxënës se në planifikimet e Ekzekutivit të Komunës është rregullimi i një fushë të sporteve në hapësirat e shkollës përkatëse, projekt për të cilin shpresoj se në një të ardhme të afërt do të bëhet realitet. Pra kjo ishte ajo që më bëri të marr fjalën, mirëpo do të ceku edhe një gjë, ne sot promovuam një Grup të ri të këshilltarëve, më vie mirë që kjo u mirëprit nga kolegët tanë ku shumica folën mirë për këtë gjë e cila na bënë të ndihemi mirë.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, ndoshta kjo pyetje që do të parashtroj nuk është për Kryetarin e Komunës por për vartësit e tij, mirëpo mbase është prezent Kryetari i Komunës po e shfrytëzoi rastin të parashtroj këtë pyetje, cila është arsyeja që Udhëheqësi i Personelit apo drejtori i Drejtorisë përkatëse në Komunën e Podujevës, nuk e zbaton Aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit për kthimin në punë të aktivistes së Partisë Demokratike të Kosovës znj. Hanëmshe Berisha. Unë e posedoj Aktvendimin e formës së prerë, pa të drejtë ankese, kurse në anën tjetër kemi një përgjigje që Komuna e Podujevës e cila e ka njoftuar Gjykatën përkatëse para rreth një muaji se punëtorja e cekur do të kthehet në vendin e punës, ndërsa në realitet kur e cekura ka ardhur në Komunë për të filluar punën ka qenë një përgjigje tjetër, andaj kërkoj nga Kryetari i Komunës që në bazë të kompetencave që ka dhe në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit si formë e fundit ligjore, të urdhëroi vartësit e tij përgjegjës që punëtorja e cekur të kthehet në punë me aktemërimin e vitit 2012. Unë personalisht i kuptoj veprimet politike që janë bërë, ndoshta edhe Kryetari i Komunës nuk është i informuar sa duhet mirëpo punëtorja e cekur është larguar nga vendi i punës në mënyrë politike në kohën e fushatës zgjedhore në zgjedhjet e fundit lokale, çështje e cila nuk mendoj se e rritë demokracinë e këtij Kuvendi, për të cilën u fol më parë në këtë mbledhje, dhe nuk e rritë demokracinë këtyre subjekteve politike, kështu që mendoj se Shefi i Personelit z. Ahmet Ahmeti është i obliguar dhe duhet të zbaton Vendimin e Gjykatës për arsye se as ne si subjekt politik por as punëtorja e cekur, nuk do të donim të ngritim një kallëzim penal i cili do të penalizonte Kryetarin e Komunës por edhe Shefin e Personelit.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, sa unë jam i njoftuar, punëtorja e cekur nuk është larguar nga puna, por asaj vetëm i është ndërruar vendi i punës pasi që ka qenë e nevojshme që në pozitën që ka punuar të caktohet një punëtor me kualifikim përkatës për të cilën pozitë e përmendura nuk ishte e kualifikuar. Procesi i lëvizjes është bërë konform rregullativës ligjore që i referohet Shërbimit Civil. Meqë kjo çështje ka hyrë në rrugë gjyqësore, unë nuk dëshiroj të jap kurrfarë përgjigje, por do të pres vendimin përfundimtarë të Gjykatës, dhe sigurisht se çdo vendim të Gjykatës ne do ta zbatojmë.

Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11;00

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-39128
Podujevë,
30 prill 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**